

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

V E N D I M

Nr. 7, datë 20/2/2019

“PËR

SHPALLJEN E THIRRJES PËR APLIKIM PËR KANDIDATËT PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIM QË DO TË VOTOHEN NGA STUDENTËT E UPT”

Mbështetur në ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhërin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 41, datë 24.01.2019, "Për Njoftimin e Fillimit të Procedurave të Përzgjedhjes së Anëtarëve të Bordit të Administrimit, Mënyrën e Vlerësimit të Kandidatëve dhe Afateve të Dorëzimit të Dokumentacionit" si dhe shkresës së Rektorit nr. 64/1, datë 19.02.2019, "Për shpalljen e thirrjes për Aplikim për kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsim që do të votohen nga studentët e UPT", Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), në mbledhjen e radhës të zhvilluar në datë 20.02.2019,










VENDOSI:

1. Shpalljen e kriterëve të pranimit për kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsim që do të votohen nga studentët e UPT.
2. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët dhe dokumentacioni i paraqitur të jenë në përputhje me shtojcën nr.1 të Urdhrit nr.41 të MASR, datë 24.01.2019.
3. Publikimin e kriterëve të pranimit në ambjentet e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe në faqen web www.upt.al.
4. Ngarkimin e KZF-ve, të UPT për publikimin e këtij vendimi dhe kriterëve të pranimit në ambjentet e tyre.
5. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Senatit Akademik, përfaqësuesve të studentëve.
6. Afati i aplikimit fillon në datën 20.02.2019 dhe përfundon në datën 26.02.2019 ora 16:00.
7. Dokumentacioni dorëzohet pranë sekretarisë së KIZ, UPT Sheshi Nënë Tereza, Nr.4 Tiranë

Bashkëngjitur vendimit shtojca nr.1 e Urdhërit nr.41 të MASR datë 24.01.2019, "Për Njoftimin e Fillimit të Procedurave të Përzgjedhjes së Anëtarëve të Bordit të Administrimit, Mënyrën e Vlerësimit të Kandidatëve dhe Afateve të Dorëzimit të Dokumentacionit"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

- | | | | |
|----|-----------------|---------|---|
| 1. | Gjergji ISLAMI | Kryetar |  |
| 2. | Altin MARAJ | Anetar |  |
| 3. | Spartak KUÇAJ | Anetar |  |
| 4. | Renalda KUSHE | Anetar |  |
| 5. | Lindita DHAMO | Anetar |  |
| 6. | Luan MURTAJ | Anetar |  |
| 7. | Gjon KAZA | Anetar |  |
| 8. | Albina BASHOLLI | Anetar |  |
| 9. | Enrik SHEHU | Anetar |  |

